



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**MUNDËSI PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË
GJEORGJI, VITI AKADEMIK 2016-2017**

Universiteti Shtetëror "ILIA" në Tbilisi, Gjeorgji, ofron mundësi për studentët e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në programet "Bachelor" dhe "Master" në gjuhën angleze, për vitin akademik të 2016-2017.

*Programet për studime **universitare** ofrohen për:*

1. Bachelor në Administrim Biznesi (BBA, menaxhim, turizëm);
2. Bachelor në Inxhinieri kompjuterike;
3. Bachelor i Shkencave (BSc) në Inxhinieri Elektrike (studime universitare: bachelor dhe master);
4. Bachelor i Shkencave (BSc) në Inxhinieri Elektronike (studime universitare: bachelor dhe master).

*Programet për studime **pasuniversitare** ofrohen për:*

1. Master në Administrim Biznesi (MBA);
2. Master në Shkencat Pyjore dhe për Burimet Natyrore;
3. Master i Shkencave (MSc) në fushën e Gjenetikës së Aplikuar.

Krahas programeve të mësipërme të studimit, Universiteti Shtetëror "ILIA" ofron, gjithashtu, për studentët e avancuar ndërkombëtarë programe studimi për zotërimin e gjuhës angleze. Me përfundimin e tyre studentët e huaj marrin certifikatën ndërkombëtare të njohjes së gjuhës angleze: TOEFL ose ITP.

Programet përfshijnë edhe pjesëmarrje në seminare për komunikimin ndërkulturor, si dhe në një numër aktivitesh jashtë procesit akademik për të lehtësuar integrimin normal të studentëve ndërkombëtarë në Gjeorgji.

Universiteti Shtetëror ILIA në Tbilisi, Gjeorgji, ofron bursa deri në 50% për mbulimin e taksave shkollore të studentëve të huaj të përzgjedhur mbi bazën e meritave të tyre akademike.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, referojuni materialeve informativë që gjenden në adresën web-site:

<https://iliauni.edu.ge/en/international>;

e-mail: international@iliauni.edu.ge;

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE